

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237,  
ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	KEK-24-10965-1-2-1
Nr i brendshëm	KEKC-24-332-121

Sa i përket tenderit për: **Furnizim me ftohës te vajit për kushineta te dyfishta.**

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

*Gazmend Bojku B.I"*

*(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)*

**RR. "BETEJA E KOSHARES"**

*(Adresa)*

**PEJË**

*(Vendi)*

**30000**

*(Kodi postar)*

**045 500 800**

*(Numri Telefonit)*

*(Numri i Faks-it)*

**Gazmend BOJKU**

*(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)*

**bojku.hidraulik@yahoo.com**

*(Adresa elektronike)*

**14.02.2025**

*(Data e parashtrimt të ankesës)*



*(Nënshkrimi dhe vula)*

\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

#### 2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Data e njoftimit për kontratë: 17.10.2024  
Hapja e ofertave: 08.11.2024  
Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 22.01.2025  
Kërkesës për Rishqyrtim e dt. 27.01.2025  
Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim: 05.02.2025

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☒

E kemi pranuar Procesverbalin e Hapjes përmes E-prokurimit.

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☒

Jo

☐

### 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

Po

☒

Jo

☐

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

**Neni 1 i LPP-së**  
**Neni 7 i LPP-së**  
**Neni 52 i LPP-së**  
**Neni 59 i LPP-së**  
**Neni 60 i LPP-së**  
**Neni 69 i LPP-së**  
**Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik.**

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Data e njoftimit për kontratë është bërë me dt.17.10.2024, kurse hapja e ofertave është bërë me dt. 08.11.2024.

Njoftimi mbi vendimin e AK-së është bërë me dt.22.01.2025 ku është rekomanduar për kontratë OE ELPROJEKT SHPK €, ndërsa neve na është dërguar letra standarde për tenderues të pasuksesshëm.

**Ne kemi pasur qasje në dokumentacion të OE të rekomanduar për kontratë, ndërsa gjatë analizimit të dokumentacionit të OE të rekomanduar për kontratë kemi vërejtur se ky OE është i papërgjegjshëm për arsyet që do të elaborojmë më poshtë.**

Fillimisht po e sqarojmë se AK-së gjatë vlerësimit të tenderëve i ka kërkuar sqarime shtesë OE të rekomanduar për kontratë pasi që i njëjti ka prezantuar katalogun me 7 lloje të modelit të kërkuar, të cilat dallojnë në specifika nga njëra-tjetra.


OE i rekomanduar për kontratë ka kthyer përgjigje ku tani pas sqarimeve ka nënvizuar vetëm njërin nga modelet e prezantuara në katalog.

Kur analizohet katalogu i prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë pas sqarimeve shtesë, shihet se i njëjti OE ka ofertuar me modelin **MG 80-310**.

TIPO TYPE	PORTATA OLIO OIL FLOW (l/min)	HP DISSIPATI CON OLIO HP DISSIPATED WITH OIL =55°C H2O=20°C	CAPACITÀ CONTENTS (lt)	Kg	DIMENSIONI - Overall dimension												
					ØF	I	L	L1	1 Pass			2Pass			4Pass		
									A	B	C	A	B	C	A	B	C
MG 80-150...	25-70	4-8	0.65	4.5	1"	150	321	141	90	90	85.5	72	64	67	72	64	67.5
MG 80-310...	25-80	7-14	1.1	5.7	1"	310	481	301	90	90	85.5	72	64	67	72	64	67.5
MG 80-385...	25-80	9-17	1.3	6.0	1"	385	556	376	90	90	85.5	72	64	67	72	64	67.5
MG 80-560...	25-80	12-20	1.9	7.5	1"	560	731	551	90	90	85.5	72	64	67	72	64	67.5
MG 80-715...	35-120	15-24	2.3	8.0	1"	715	886	706	90	90	85.5	72	64	67	72	64	67.5
MG 80-870...	40-130	18-29	2.8	10.0	1"	870	1041	861	90	90	85.5	72	64	67	72	64	67.5
MG 80-1155...	40-130	22-36	3.7	13.5	1"	1155	1326	1146	90	90	85.5	72	64	67	72	64	67.5

Nga faktet e lartcekura shihet qartë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për faktin se produkti me të cilin ka ofertuar nuk është konform specifikimeve teknike të kërkuara në dosje të tenderit.

Dimensionet e kërkuara janë si në vijim: **485mm, 415mm, 60mm**; Produkti i kërkuar me këto dimensione në dosje të tenderit, nuk është prezantuar edhe nga OE i rekomanduar për kontratë sepse i njëjti produktin e tij e ka prezantuar me dimensionet e lartcekura ndërsa në dosje të tenderi është specifikuar si më poshtë):



:

Kur krahasohet katalogu i prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë dhe specifikat teknike të specifikuara në dosje të tenderit nuk janë në përputhje me njëra tjetrën, andaj si e tillë oferta e OE të rekomanduar për kontratë është e papërgjegjshme dhe i njëjti është dashur të eliminohet nga aktiviteti i prokurimit dhe jo të rekomandohet për kontratë nga ana e AK-së.

Duke u bazuar në të gjitha faktet e lartcekura kuptohet qartë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm dhe si i tillë është dashur të konsiderohet edhe nga ana e AK-së, mirëpo që një gjë e tillë nuk është bërë duke e favorizuar OE të rekomanduar për kontratë.

Ne me dt.05.02.2025 kemi vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, me arsyetimin se e njëjta është e pa bazuar, mirëpo që në vendim nuk janë dhënë fakte konkrete për një refuzim të tillë.

Autoriteti kontraktues në vendimin e tij për refuzim të kërkesës për rishqyrtim ka dhënë arsyetimin si në vijim:

Komisioni teknik i vlerësimit qendron prapa vendimit të dhënë dhe se është bërë trajtimi i barabart i OE duke respektuar LPP në përpikëri. Në vijim paraqesim kundërshtimin në pretendimet tuaja;

Dimensionet e ftohesit të ofruar nga OE i propozuar për kontratë me dimensionet e ftohesit të kërkuar janë të papërfillshme, që nuk ndikojnë në kapacitetin dhe montimin e ftohesit, OE ELPROJEKT ka ofru tipin e ftohesit të kërkuar që i plotëson kriteret teknike të ftohesit të kërkuar.

Komisioni i vlerësimit rekomandon që të refuzohet ankesa si e pa bazuar e Gazmend Bojku B.I. dhe të mbetet në fuqi rekomandimi i komisionit.

Nga vet arsyetimi i AK-së kuptohet qartë se dimensionet e ftohesit nuk janë prezantuar sipas kërkesës së autoritetit kontraktues, mirëpo i njëjti me qëllim që të favorizoj OE të rekomanduar për kontratë i ka quajtur të papërfillshme dimensionet e kërkuara nga vet AK-ja.

Pra në këtë rast me qëllim të favorizimit të OE të rekomanduar për kontratë, autoriteti kontraktues nuk po i cilëson si të papërfillshme dimensionet të cilat janë kërkuar nga vet AK-ja, andaj këtu shihet qartë diskriminimi po na bëhet neve si OE i vetëm i përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit dhe favorizimi që po i bëhet OE të rekomanduar për kontratë, ku i njëjti edhe pse nuk ka ofertuar konform kërkesave të dosjes së tenderit po rekomandohet për kontratë.

Kërkojmë nga ana e ekspertit shqyrtues dhe panelit shqyrtues të OSHP-së që ti analizojë në detaje pretendimet tona ankimore dhe refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, ku vet AK-ja e ka pranuar që OE i rekomanduar për kontratë nuk ka prezantuar produktet sipas dimensioneve dhe në fund të nxjerrjet një vendim meritore në lidhje me ankesën tonë.

Në këtë aktivitet të prokurimit nuk është bërë ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së, përkitazi me ofertën e OE të rekomanduar për kontratë, prandaj duhet rishqyrtuar edhe njëherë ky aktivitet i prokurimit me të gjitha dëshmitë e ofruara.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët** siç parashihet edhe në nenin 60 paragrafi 1.2 i LPP-se sepse është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik i papërgjegjshëm.

Në këtë aktivitet të prokurimit nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, sepse është favorizuar operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë duke u rekomanduar për kontratë edhe pse nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “*Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse*”, mirëpo në këtë rast AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore sepse oferta e OE të rekomanduar për kontratë nuk i plotëson të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit.

Gjithashtu nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në faktet që u përmenden me lartë, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që të shqyrtoj ankesën tonë dhe të nxjerr:

## VENDIM

**APROVOHET**, si e bazuar ankesa e grupit të OE “**Gazmend Bojku**” B.I.

**ANULOHET**, njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM**, **DETYROHET** autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente, dhe sinjalizimin për të gjitha shkeljet ligjore që konsiderojmë se kanë ndodhur në këtë procedurë tenderuese.

## **9. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim, ankesës në vlerë prej 5,000.00 euro.

## **10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*